

TAKIJA MYZEQARE DHE DISA DËSHMI PELLAZGO-ILIRE-ARBËRORE

Maksim ZARKA

Studiues, Akademia “Rrënjët Tona”

PËRMBLEDHJE

Para se të flas për veshjet në Myzeqe, dua të jap një mendim të shkurtër se kush quhet (është) myzeqar. Po ndalem pak tek ky koncept, pasi shpesh abuzohet me qënien myzeqar ose jo. Kështu ka individ që si kriter për të qenë myzeqar përdorin besimin fetar. Sipas tyre ata banorë të Myzeqesë, të cilët janë të besimit mysliman nuk na qenkan myzeqarë. Vetvetiu të lindin disa pyetje: A e pranojnë këta që janë autokton?, A kanë qënë para pushtimit turk të krishterë? Përgjigja do të ishte: Po, kemi qënë të krishterë. Po kur ishin të krishterë, a ishin myzeqarë? Besoj se po, ishin myzeqarë dhe e pranojnë. Vijmë në ditët e sotme. Fshati Belinë apo Kallm¹ është i gjithë i besimit mysliman. Vallë nuk janë myzeqarë banorët e këtyre fshatrave? Patjetër që janë. Marrim Mallakastrën. Kur mallakastriotët ishin të krishterë, vallë nuk ishin dhe quheshin mallakastriot. Padyshim që po. Dhe tani që janë të besimit mysliman, mallakastriotët janë përsëri. Po ata banorë të krahinës së Labërisë² që janë të krishterë, nuk janë lebër?

Fjalë kyçe: takija myzeqare, dëshmi pellazgo-ilire-arbërore, lebër, veshje, myzeqar.

ABSTRACT

Before I talk about the outfits in Myzeqe, I want to give a brief thought about who is called (is) myzeqe. I am dwelling a little on this concept, as it is often abused to be musky or not. Thus there are individuals who use religious belief as a criterion for being a musketeer. According to them, those inhabitants of Myzeqe, who are of the Muslim faith, are not myzeqeres. Naturally, some questions arise: Do those who are autochthonous accept it? Were they Christians before the Turkish occupation? The answer would be: Yes, we were Christians. But when they were Christians, were they musketeers? I believe so, they were reluctant and accept it. We come to the present day. The village of Belina or Kallm is all of the Muslim faith. Aren't the inhabitants of these villages greedy? Definitely are. We take Mallakastra. When the Mallakastriot were Christians, were they not and were called Mallakastriot? Definitely yes. And now that they are of the Muslim faith, the Mallakastriot are again. What about those inhabitants of the province of Labëria who are Christians, are not lepers? Undoubtedly lepers are.

Key words: myzeqare takija, Pelasgian-Illyrian-Arberian evidence, leprosy, clothing, musketeer.

HYRJE

Në rast se nuk duan ta quajnë veten myzeqarë, sot disa syresh banorë të myzeqesë të besimit mysliman, çfarë janë, cilës krahinë i përkasin? Eshtë shumë i gabuar mendimi, që kushtëzon qënien si pjesëtar natyral i një krahinë me besimin fetar. Besimi vete e vjen. Ai pëson ndryshimet e tij, sipas kushteve historike. Dikur si kudo dhe në Myzeqe besimi ishte pagan, pastaj i krishterë, më vonë një pjesë e banorëve kaloi në mysliman. Madje, sot një pjesë e banorëve të besimit mysliman janë pagëzuar dhe kanë përqaftuar besimin e krishterë. Pra, siç shihet *të njëjtët banorë kanë ndryshuar disa herë fenë, por në çdo kohë e në çdo besim që përqaftuan ata, kanë qënë dhe kanë mbetur myzeqarë takije-bardhë*. Shkenca e

¹Të dy fshatrat janë në lindje te Fierit.

²Në Tepelenë ka fshatra si ai, Rexhinë, që banorët e saj janë të besimit të krishterë. Dhe ata me të drejtë e quajnë veten lebër dhe janë lebër. Dhe askush deri tani nuk e ka vënë në diskutim.

sociologjisë na mëson se elementët që përbëjnë njësinë e një popullsie të një vendi apo në krahinë janë respektimi i tre parimeve:

1. Parimi etnografik. – veshja + doket (ritet në gëzim e hidhërim) + muzika, kënga, vaj, vallja³, mënyra e të ushqyerit, etj.
2. Parimi dialektologjik;
3. Parimi antropologjik;

Ndikim jo të plotë e as thelbësor, ka patur besimi mysliman vetëm tek parimi i parë, ai etnografik. Them jo i plotë, pasi ndryshimi i besimit nuk mundi të ndryshojë as doket dhe as veshjen kryesore. Ky ndikim që më i theksuar tek shtresat e pasura, veçanërisht në qytet. Përsa i përket parimit dialektologjik, ndryshimi i besimit nuk ndryshon asgjë. Si banori i krishter dhe ai mysliman flasin të njëjtën gjuhë dhe të njëjtin dialekt. Parimi antropologjik është po i njëjtë pasi janë produkt i një dheu, i një rreze dielli, i një klime dhe i një gjaku.. Atëherë themi, se banorët e Myzeqesë quhen dhe janë të gjithë myzeqarë, se formojnë prej kohësh një bashkësi ekonomike e shoqërore njerëzish, me kushte shoqërore të njëjta, me mënyrë të përbashkët jetese, me tradita kulturore të njëjta dhe me të folme të njëjtë. Kështu, që t'i vëmë kokë këtij mendimi që hodhëm në fillim të kësaj eseje, myzeqar është si banori i krishterë dhe ai i besimit mysliman.

VESHJA - PJESE E KULTURËS IDENTITARE E NJË KOMBI

Çdo komb ekziston dhe zhvillohet në saj të vijimësisë shpirtërore që ndjek dhe vlerave që krijojnë në rrugëtimin e tij historiko-jetësor. Po ja shtrëmbërovet, po ja mohovet, po ja zhduket kulturën shpirtërore dhe materiale një kombi, ke realizuar jo vetëm pushtimin e tij, por dhe zhbërjen e identitetit të tij. Në kulturën materiale bënë pjesë dhe veshja. Veshja bënë pjesë te gjuha e jashtme për një komb. Është tregues identifikues etniciteti për një popull. Kështu sapo shohim një qytetar me veshje arabe, ne menjëherë themi: “Ai është arab”. Kur shohim një qytetar me fustanellë me kuadrata, dhe me një toptë mbi berete në kokë, themi: “Ai qenka skocez”. Në shekullin 18^{-të} dhe 19^{-të} të shek.20^{-të}, të huajt sa shikonin një person me fustanellë të bardhë, menjëherë e identifikonin me emrin shqiptar. Kur shikonin një luftëtar me poture, e identifikonin me ushtarin turk etj.

Në këtë këndvështrim, një nga detyrat e etnografisë është dhe mbetet hulumtimi, ruajtja dhe pastrimi i veshjes nga ndikimet e huaja si dhe dhe pasurimi i saj. Dje, kultura materiale dhe shpirtërore ishte e rrezikuar nga kultura e pushtuesit, sot nga bota e hapur dhe kozmopolitizmi. Mbrojtja më e mirë është jo mbyllja, por ruajtja, pasurimi dhe promovimi i kulturës së popullit tënd. Shkalla e pasurisë dhe pastërtisë së veshjes, është tregues i nivelit të kulturës së veshjes të një kombi.

Çdo popull ka trashëguar veshjen e tij, ku formatohet dhe ai që quhet kostum popullor. Padyshim dhe populli ynë shquhet për një veshje sa të larmishme, aq dhe unike. Kostumet popullore tregojnë dhe janë elemente përbërëse të identitetit të popullit shqiptar. Në një kuadër më të gjerë, ato janë dhe pjesë e

³Banorët e Myzeqesë pavarësisht besimit kanë të njëjta valle e këngë dhe të njëjtë veshje. Takije ka mbajtur si myzeqari mysliman dhe ai i krishter. Madje artisti popullor Joti Prifti (nga Marinza) e kërcente Vallen Dyshe Myzeqare me mjeshtrin tjetër Heko Lëngu (nga Kumani), apo Sotir Goga me Ali Çepelen. Të dy nga Matka e Roskovecit.

identitetit evropian. Këto të fundit pasqyrojnë një pjesë të kulturës materiale të popullit tonë. Kostumet me elementet e tyre në përbërje e në prerje, me ngjyrat e ndezura mesdhetare, me mënyrën e veshjes, të përdorimit, të kompozimit, të llojshmërisë së ornamentëve, tregojnë në mënyrë specifike edhe shijet artistike të popullit. Kjo kulturë materiale është e krijuar në shekuj, me fillesë që në paleolitin e vonë⁴ dhe ështëformësuar gjatë formimit të bashkësisë ekonomike e politike të popullit shqiptar. Sipas studiuesve, zanafilla e këtij formësimi është në shek. XII dhe te Principata e Arbërit. Veshja, si pjesë e etnografisë shqiptare, ka ndjekur rrjedhën e zhvillimeve historike të kulturës shoqërore e materiale, duke u konsoliduar me formimin e shtetit nacional shqiptar më 1912. Në rrugën e gjatë të formësimit dhe të zhvillimit, veshja shqiptare është “përplasur” dhe me ndikimet e huaja të kulturës bizantine dhe turke. Mund të themi se disa copëza ornamentesh të ndikimit bizantin, për shkak të fesë krishtere, (e cila është feja e Evropës dhe jona), janë ngjizur natyrshëm në kostumin shqiptar. Ndërsa ndikimi turk, megjithëse “depërtoi” me elementë përbërës në veshjen shqiptare, siç janë poturet dhe shallvaret, nuk u përshtat dhe nuk ngjiti me shijen artistike të veshjes sonë.

Veshja e Myzeqarit - (llojët dhe përbërja e kostumit të tij)

Mashkulli myzeqar sipas periudhave kohore nga antikiteti deri ne kohën moderne⁵(perjashtuar kohën bashkohore)ka mbajtur këto llojë veshje:

a- Veshja me këmishë (linjë).

Kjo veshje ka këto elementë: Takija, këmisha-linjë (tip fustani), fanella që vishej sipër këmishës(në dimër), peshqiri, të mbathurat e gjata, brezi, çorapet, opingat dhe guna çile(per barinjte), guna larë (bujkun) dhe guna me xhokë (për festë, martesë etj)

b-Veshja me fustanellë.

Kjo lloj veshje përbëhet nga: Takija, fanella, këmisha, të mbathurat, fustanella, brezi, mëngorja, peshqiri, dorakët, kalcet, çorapet, opingat dhe guna çile(per barinjte), guna larë(bujkun) dhe guna me xhokë(për fest e martesë)

c- Veshja me tirqe të gjata

Kjo lloj veshje përbëhet nga: Takija, fanella, të mbathurat, brezi, mëngorja, tirqet, peshqiri, dorakët, çorapet, opingat dhe guna.

ç- Veshja me qillota.

Elementët e kësaj veshjeje janë: Takija, fanella, të mbathurat, qillotat, peshqiri, çorapet, opingat(këpucët) dhe guna.

Siç e shikoni në të gjitha llojet e kostumit myzeqar dhe të evoluimit të tij ka mbetur e pandryshueshme kësuala me emrin TAKIJE, për të cilën do të flasim në këtë artikyull⁶. Kemi tre tipe takijesh:

⁴ Paleoliti i vonë përfshin periudhën kohore nga 30 000-vjet deri 10 000-vjet para erës së re

⁵ Koha bashkohore quhet periudha kohore nga viti 1945 e ne vazhdim

⁶ Këtë studim e dikton dhe fakti se Takija nuk gjendet si suvenire, por dhe ‘harrohet’ në evinimente me karakter kombëtar. Më datën 02.01.2017, TVSH dhe TV Klan shfaqti Trupen e Orkestres Filarmonike të Vjenës me 36 muzikante, ku luante violinist Shkelzen Domi. Në një moment interpretimi orkestranët vunë në kokë qeleshen kosovare, qylafin lab dhe qylafin geg. Takije nuk kishte. Spikerja e TV Klanit në emisionin e lajmeve të mbrëmjes i mëshoi këtij fakti duke theksuar se kur u luajt valsi i “Danubit Blu”,

- Takija myzeqare në formë konike dhe e zbukuruar me damarë që përdoret në pjesën fushore të Myzeqesë.
- Takija sulovare ose takija shytë me majë në formë koni të prerë.
- Takija toske në formë konike si dhe takija myzeqare por shumë e zbukuruar me qëndisma, e cila është përdorur në krahinën e Beratit dhe të Myzeqesë. Një takije të tillë të zbukuruar me qëndisma zakonisht përgatitej për dhëndrin kur merrte nusen.

Para se të flas mbi dëshmitë burimore për Takijen, dëshiroj ta njoh lexuesin apo ndonjë studjues me imazhet (fotot) e kësulës së takijes që folta më lart dhe që janë përdorur deri në vitet 60^{-të} të shek.20^{të}, të cilat përdorin aktualisht nga Asambletë e Këngës dhe Valles Myzeqare në Fier, Lushnjë e gjetkë. Kjo do t'ju mundësojë atyre të bëjnë dhe krahasimet me dëshmitë burimore të imazheve që na vijnë nga antikiteti.

Disa foto dhe imazhe të Takijes aktuale



Fig. - 1

Takija në gjëndje të lirë. E bardhë borë si maja e malit Tomorr. Me rrëkezat dredha-dredha që rrjedhin si pika lot.




Fig. - 2

Takije myzeqari (toske) me qëndisma. E mbante dhëndri, ose djemtë e rinj në festa fetare ose laike.

muzikantët vendosen kësula nga të gjitha krahinat shqiptare!. Një informacion ky kulturor jo i plotë. Mungonte TAKIJA e Myzeqesë!



Fig. - 3
Valltar me takije
Frashër të Fierit
V.2015



Fig. - 4
Takija Shytë. Mbahet në
Dumre, Shpat, Elbasan. Ka
hyrë pjesërisht në Myzeqe

DËSHMI për Takijen parailire pellazge

Ndryshe nga qylafi që është me ndikim turk, takijaruan plotësisht autoktoninë e saj parailir, ilir dhe arbëror në trevën e Myzeqesë dhe të Toskërisë. Për të argumentuar lashtësinë parailire të Takijesë myzeqarit, na vjen në ndihmë albanologu i shquar Prof.Dr. Dhimitër Pilika, i cili shkruan: “Edhe Dyrrahu, në monedhat e veta, i nderon posaçërisht Dioskurët, duke pavdeksuar emblemën e tyre numër një, takijen stërgjyshore - tregues i gjallë etniciteti parailir që u soditim mbi krye, në përmedore antike, edhe Karontëve, Odiseve, Patroklëve, Aiaksëve⁷ me shokë, si shënjë e qartë prejardhje parahelene”⁸. Nga ky pasazh mund të nxjerrim disa përfundime:

- Takija ka qënë emblemë numër një e Dioskurëve⁹.
- Takija ka qënë kësulë e stërgjyshëve të Dioskurëve dhe ata duke e mbajtur në kokë e ruanin dhe e nderonin atë si emblemë.
- Takija është tregues gjallë i entinitetit parailir, d.m.th. është pellazge. Kjo do të thotë që kemi një dëshmi të veshjes para ilire që është takija dhe që këtë sot e mbajnë myzeqarët dhe...

Na tregon se përmendoret antike të Karontëve¹⁰, Odiseve, Patroklëve, Aiaksëve me shokë të skalitur në gurë apo në bronzë në kokë kanë takijen. Ekzistenca e Takijes në kokën e Odisesë, Karontit, Akilit, Patroklit etj. tregon qartë se TAKIJA është para helene, parailire, qëdo të thotë është pellazge¹¹

⁷ Aiaksët quhen të gjithë ata burra që rrjedhin nga dinastia e Aiakut → Akili → Pirro Neoptolemi ...Tharipa→Alketa→Arriba→Aiakidi→Pirrua i Epirit. Prej djali të Akilit deri te Tharipa janë pesëmbëdhjetë breza.

⁸ Dhimitër Pilika. Pellazgët Origjina Jonë e Mohuar, Tiranë: Botime Enciklopedike, 2005, f.105

⁹ Dioskuret janë dy vëllezër binjak të lindur nga zoti Dodonas me Ledën pellazgjike.

¹⁰Karonti është varkëtar i që kalonte kudrejt pagesës të vdekurit në anën tjetër të lumit.

¹¹ Dy janë kësula para ilire dhe ilire: Takijes e Myzeqarit dhe Plisi i Kosovarit

Për arsye historike, myzeqarët dhe toskët (takija është toske) nuk kishin mundësi të ngrinin këto vlera artistikisht, po edhe ato pak që patëm i zhdukën barbarët dhe vetë pluhuri i kohës. Falë të huajve, të cilët e konceptuan veshjen (kësulën) sipas përfytyrimit të tyre dhe dëshmime të antikitetit të gjetura në vizatim ose të gdhendur në gurë e në mermerë, na kanë dhënë vepra artistike, ku si veshje në kokë mbajnë Takijen e Myzeqarit ose Plisin e Kosovarit.

Imazhe nga antikiteti për Takijen



Fig.- 5
ODISEU 3250 vjet më parë



Fig. - 6
Myzeqari me takije Asambli
Myzeqeja Fier v.2019



Fig. - 7
Polydeuku me Takijen në
kokë mund Lynkeun.
Vepër artistike gjetur në
Dodonën pellazge.



Fig. - 8
Hefesti
Kësula e ngjashmeme takijen
myzeqare. Perenditepellazge,
nuk ishin greke




Fig. - 9
Kroni pellazg




Fig. - 10
Flijimi i Efigjenisë së Agamemnonit
Vini re Takijen në kokë, 1250 vjet para
Krishtit

Dëshmi për takijen ilire

Takija si kësulë kokë është mbajtur që në kohën e ilirëve. Më vonë përdorimi saj si veshje koke u rrudh në arealin e Toskërisë. Më kalimin e shekujve, rrudhosja u thellua dhe siç thekson A. Gjergji u ruajt vetëm në Myzeqe, Sulovë, Elbasan, Shpat, Berat, Skrapar¹², etj. Dëshmitë për takijen ilire na vijnë nga gjetjet arkelogjike. Në Mborje të Korçës është gjetur në bronz një shtatore¹³, e cila i përket shek.-VI para Krishtit, ku dallohet shumë qartë takija në kokë. Në Apolloni është gjetur një skulpturë e derdhur në bronz që mban në kokë një kësulë të ngjashme me takijen. Kjo është krejt ilire dhe s'ka ngjashmëri me veshjet helene.¹⁴ Në Elbasan është gjetur shtatorja e një bariu ilir, i cili në kokë mban takijen. Kjo skulpturë i përket shek. - I para Krishtit. Për këtë shtatore, Dh.Pilika shkruan: *“Te një objekt prej bronzi, shek.- I para erës sonë, gjetur në rrethin e Elbasanit, mbi kokën e një bariu ilir spikat plisi vezak(takija), simbol i filizave të Zotit pellazgdodonas¹⁵”*.

¹² Andromaqi Gjergji, *Veshjet Shqiptare në Shekuj*, Tiranë: Botim i Akademisë së Shkencave të RPS të Shqipërisë, V.1988, f.206

¹³ Neritan Ceka, *Iliret deri te Shqiptaret*, Tiranë: Migjeni, 2014,

¹⁴ Shih “Shqipëria etnografike”. fig.71, v.1971

¹⁵ Dhimitër Pilika. *Pellazgët Origjina Jonë e Mohuar*, Tiranë: Botime Enciklopedike, 2005, f.106

Ndërsa në Amantia është gjetur një skulpturë, ku paraqitet një i ri me trup atleti i derdhur në Bronx, që i përket shek.IV-III p.e.s, i cili mban në kokë një lloj kësule që ka ngjashmëri me takijen. Kemi një tjetër gjetje arkeologjike në Selcë të Pogradecit, ku paraqitet një artist në Bronx, me një tip çapare në dorë, por që në kokë ka një kësulë tepër të ngjashme me takijen. Po kështu, në një afresk të vitit 1576 në Kishën e Panaiasë së Dhërmiut në Vlorë, paraqitet klitori ulur në gjunjë, në kokë ai mban një takije të bardhë të ngjashme me ato të Myzeqesë - na thotë Prof.dr.Andromaqi Gjergji. Nga Korça na vijnë një dëshmi tjetër: një gurë varri që i përket shek.II-III pas Kr, ku janë skalitur dy farkëtarë. Tek koka e të djathtit duket qartë një mbulesë koke e ngjashme me atë të myzeqarit.



Fig. - 11
Takija - Rrënja Jonë
Gjetur në Mborje të Korçës.
Shek.VI para Krishtit



Fig. - 12
Skulpturë në bronz. Gjetur
në Apoloni. Muzeu
arkelogjik dhe
Etnografik. Tiranë. Shqipëria
etnografike. Viti 1971



Fig. - 13 Bari Ilir
shek. I p. e.s.Gjendur në Elbasan



Fig.14
Gurë varri.
Gjetur në Korçë. Farkëtarë i
djathtë ka
në kokë një takije myzeqari.
Shek.II-III erës sonë.



Fig. - 15 Takije e ngjashme me atë të Myzeqesë
Bronx, Gjetur në Selcë të Pogradecit.



Fig. - 16
Myzeqarët me Takije.
Krahasoheni me bariun ilir.

Takija arbërore e pasqyruar në dokumenta

Deri tani dëshminë e parë dokumentare për kësulën e myzeqarit, ‘Takijen’, na e bie historiani Prof.Dr. Petrika Thëngjilli, i cili shkruan: “Në vitin 1583 në qytetin e Beratit kishte 638 zejtarë, nga këta 51 (pesëdhjetë e një) ishin takijexhi (takijebërës). Vetë numri 51 i zejeve takijebërës, tregon për një përdorim të gjerë të takijës nga Myzeqeja, padyshim dhe Berati si kryeqendra e saj. Dëshmia e dytë dokumentare na vjen përsëri nga Prof.Dr. P.Thëngjilli, i cili shkruan se në shekulin e 17^{-të} në qytetin e Elbasanit kishte 36-takijepunues¹⁶, madje e jep dhe emrin një takije punuesi nga Bradasheshi i Elbasanit. Si dokument i tretë në radhën e dëshmimeve të shkruara që e përmendTakijen si mbulese koke për burra është ai i vitit 1716¹⁷. Njihen tri lloj takije:

1. Takija myzeqare në formë konike e zbukuruar me rrëkeza dhe me dymbëdhjetë rathë unazore, por ka dhe me 15 rathë unazore.
2. Takija toske, e cila është njëlloj si ajo takija myzeqare, por e zbukuruar me qëndisma. Kjo përdorej si në Myzeqe (kur djali martohej ose në festa fetare apo laike), ashtu dhe në Berat.
3. Takija e Sulovës ose takija shyte. Ka formën e konit të prerë, e cila përdoret në Sulovë dhe fshatrat kodrinore të Myzeqesë. Gjatë studimit për Takijen më kishte tërhequr vëmendjen Takija shytë e

¹⁶ Petrika Thëngjilli, Shqiptarët midis Lindjes dhe Perëndimit 1506-1839, Tiranë 2002,f.251-252

¹⁷ Andromaqi Gjergji, *Veshjet Shqiptare në Shekuj*, Tiranë: Botim i Akademisë së Shkencave të RPS të Shqipërisë, V.1988, f..37

Shpatit të Elbasanit, Dumresë e Sulovës¹⁸. Pse kjo Takije e këtyre trevave është me formë koni të prerë, që populli e quan Takija shytë? Kur e pashë me vëmendje konstatova se në fakt ajo nuk është konë i prerë. Ajo kishte formën të njëjtë me takijen e Myzeqesë dhe gjithë Toskërisë. Ajo dukej si konë i prerë kur mbahej në kokë sepse pjesën e sipërme (aty ku përfundon koni), mashkulli sulovar e shtyp duke i dhënë kështu formën e konit të prerë.

Reagimi i myzeqarëve ndaj veshjes turke

Shumëkush mendon se takija është vetëm e Myzeqesë. Por jo, takija ka qenë veshje e gjithë toskërisë, që në antikitet e deri në mesjetë. Këtë e vërtetojnë gjetjet arkeologjike që përmendëm më lart. Po pse takija sot njihet si veshje myzeqare? Logjika dhe praktika tregon, se vetëm populli i Myzeqesë e ruajti këtë vlerë të identitetit të vet dhe kombëtar, kur të tjerët e ndërruan me qylafin turk. Është kjo arsyeja që unë takijen e quaj **“Guri i bardhë”** i Myzeqesë, sepse si guri qëndroi në tokën e muzave të Apolonit. Takija është veshja tipike e kokës për myzeqarët. Myzeqari e mbante atë si në punë, në gëzim (dasëm, fejesë, etj.) dhe në hidhërim (vdekje apo fatkeqësi të ndryshme). Ai kurrë nuk e hiqte atë nga koka. Tre janë momentet, kur myzeqari e “hiqte” takijen:

1. Kur vallzonte dhe veçanërisht kur vallja ndizej flak, ai si kryevalltar e merr në dorë takijen, e tund dhe e rrotullon sikur të ketë një shamidore bardhë, duke i dhënë valles një element dinamik dhe mjaft piktoresk.
2. Momenti i dytë i “heqjes” së takijes është kur nderon një mik, kur mban një minutë heshtje në nderim të një të vdekuri të zakonshëm apo të rëni për liri.
3. Momenti i tretë, kur ekzekutohet Hymni kombëtar, si dhe kur ngrihet Flamuri Shqiptar. Në këto raste, myzeqari e “heq” takijen, e merr me dorën e djathtë dhe se bashku me dorën e vendos në zemër, duke krijuar një kompozim: **dorë - takije - zemër**, që do të thotë **nderim - paqe - dashuri**. Takija për myzeqarin është nder, krenari e qëndresë. Është fakt se ai (myzeqari) nuk e ndërroi takijen me asnjë lloj tjetër veshje koke të ndikuar nga banorët fqinj apo të huaj. Kur dikush e ndërronte takijen, ai nuk e miratonte këtë veprim, por si komunitet e kundërshtonte jo me dhunë, por me qartësi dhe me legancë e stigmatizoi.

Për këtë vuri në përdorimin armën më paqësore, por shumë të fortë, këngën: *“Kur më ke takijen, ç’e do festen¹⁹” / O djali lalës, djali i Myzeqesë / Ajo është ilirie, e ka fal perëndia / O djali lalës, djali i Myzeqesë / E huaj festeja, vjen erë Turqie / O djali lalës, djali i Myzeqesë **Marinëz – Sheqisht** / O seç mu hodhe moj pertej lumito / Thelle kishte gjer ne gjunjeto / Jarina nina, o te keqen no / Kur me ke takijen, ç ma do festen no / **Seman – Libofshë** /*

Ndaj kulturës së veshjes së huaj reagoi dhe labi edhe çami / Po citoj dy reagime/ “Festë e kuqe na zi sitë²⁰ / na veshën si arixhitë na dhanë nga tre kacidhe / fati im qiramidhe / Labëri-Çamëri“. Këto tregojnë për vitalitetin e myzeqarit. Shpirti i tij nuk është gërryer nga rrebeshet e kulturave të huaja. Kultura e huaj,

¹⁸ Sulova e Shpatit të Elbasanit

¹⁹Festja ishte simbol i turqëve reformatorë. Për herë të parë Sulltani Abdyl Mexhidi më 11-korik 1839, hoqi nga koka çallmën dhe vuri festen.Por, përsëri shija e shpirti i tij mbeti turk.

²⁰ Na zu sytë.

veçanërisht ajo osmane nuk ngjiti te myzeqari, ajo rrëshqiti si pikat e shiut në shpinë të patës. Kështu myzeqari ruajti identitetin e tij shqiptar dhe mbi të gjitha ka ruajtur shpirtin e tij të lirë dhe jo të kapur. E theksoj shpirtin e tij të lirë, pasi i lirë është njeriu, kur bën atë që i do shpirti e zemra dhe jo kur bën atë që dikton nevoja për jetesë apo lakmia për pasuri e pushtet. E myzeqari nuk e shiti shpirtin. Dhe kjo është një vlerë e madhe. Ai ishte, është dhe do te mbetet europian i patjetërsueshëm.

TAKIJA - Simbol çlirimi dhe lirie

Më ka tërhequr vëmendjen një shkrim i Mokom Zeqos mbi kësulën frigjiane. Ja çfarë ai shkruan: “Romakët, Kronin pellazg e zëvendësuan me Saturnin. Për nder të tij çdo vit më 19 dhjetor deri 24 dhjetor festonin 5 ditë saturnalet. Gjatë ditëve festive zhdukeshin dallimet shoqërore, shpesh skllevrit zinin vendin e padronëve²¹, të cilët(padronët) u shërbenin në tryezën e shtruar me të gjithë të mirat. Gjyqet dhe shkollat mbylleshin, të dënuarit nuk mund të ekzekutoheshin, armiqësitë ndërpriteshin. *Skllevrit vinin një kësule frigjiane, si shenjë çlirimi, rendnin në qytet, te dehur dhe duke kënduar.*”²² Dikush mund të thotë me të drejtë: po çlidhje ka kësula frigjiane me Takijen?! Mendoj se ka një lidhje. Argumentet janë këto:

- Kësula frigjiane, (fig.17) është identike si kësula e myzeqarit (takija).
- Frigët ishin pellazg dhe të parët e myzeqarëve (shqiptarëve) ishin pellazg.

Fig. - 17 Takija myzeqare

- Takija ka rrënjë pellazge. E kemi argumentuar më lart.
- Përmbajtja e pasazhit: “Skllevrit vinin një kësule frigjiane, si shenjë çlirimi, rendnin në qytet, te dehur dhe duke kënduar”, përkon me përmbajtjen e takijes. Dihet se Takija për Myzeqarin

ka qënë shenjë e lirisë së tij, e mos nënshtrimit shpirtëror ndaj kulturës së huaj që përpiquej me kulaç apo me shpatë pushtuesi. Por takija është dhe symbol krenarie e gëzimi, dhe ky emocion merr hov e flakërin veçanërisht kur myzeqari hedh vallen. E kundërta. A mund të quhet çlirim, gëzim dhe emocion mbajtja në kokë e çallmës, e festes apo turbanit te shqiptarët? Besoj se jo. Ndryshe nuk e hiqte nga koka Skënderbeu çallmën dhe vuri rrënjën e kësulës, përkrenaren me kokën e dhisë.



²¹ © AFP/Getty Images “...rë pesë ditë e petrit sesa i nënshtruar një vit”, pasi skllevrit më vonë reagues ndaj këtij manipulimi pesë ditë.

²² Moikom Zeqo, Dita, “Sinopse dhe skica arkelgjike”, gazeta Dita, 30 dhjetor 2019

Fig. - 18 Kësula frigjiane

Ndërtimi i Takijes

Takija e Myzeqarit përbëhet nga disa pjesë:

1-Foleja e Mençes. Është pjesa e sipërme si një grykëz e vogël me një shtypje të lehtë që myzeqarët i thonë foleja e **Mençes**.

Këtë emërtim e ka marrë nga populli i Myzeqesë, pasi kjo grykëza e vogël i ngjan dhe ka **madhësinë me folenë e bukur e të vogël të një zogu në Myzeqe** që quhet Mençe. Vetëm myzeqarët i thonë këtij zogu të vogël Mënçe, për shkak se ky zog bën një fole të vogël, shumë të bukur si nga forma dhe materiali që

përdor. Mençe do të thotë “i mençëm”, d.m.th zog i mençur

2- Gryka e konit të ngushtuar

3-Koni, që ngjan me kupën qiellore.

4-Rrathët unazor(12-15), që quhen rrathët qiellorë(hyjnorë)




Fig. - 19 Ndërtimi i Takjes

Mënyra e prodhimit të Takijes, nga mjeshtri Pandeli Koli Laze²³

Merret një cop kameri që të këtë përqindje sa më shumë pambuk. E futim në ujë të ftohtë copën prej kamerie dhe e lemë 24 orë. E thajmë dhe e shtrijmë (e tendosim). Më lindjen e hekurit (me zjarr dhe më vonë me energji elektrike) e hekurosим copën, me qëllim që ajo të shtrihet mirë. Marrim kallëpin që e kemi përgatitur më parë, i cili ka formën e një koni grykëprerë ose formën e prejeksionit të mitrës së gruas. Baza e konit e ka perimetrin rreth 52 cm. Bëjmë dy copa dhe i qepim sipas formës (konike). Baza konike bëhet sipas perimetrin të

kokës. Pastaj i futim brenda njëra tjerës dhe qepjet e tyre të jene në kundërt. Qepim buzet e pjesës konikë (bazës). E kthejmë nga e mbara dhe të qepurat ngelen nga brenda. Pas kësaj të qepurat anësore i hap (eldis) që të mos mblidhen. Fillon qepja për vënien e shiritave. Gjatë qepjes së shiritave do kujdes që shiritat të dalin nga lart (shiriti bëhe me majë spango nga maja e sixhadeve). Spangon e eldis në cop. Pasi e eldis spagon e kthen nga e mbara nga sipër dhe me gishte e madh të dorës së djathtë e shtrin duke e çar në pozicionin e duhur spagon. Pastaj bëjmë qepjen me gjilpërë. Mirë është që rrobaqepësi të përdor gishtëz. Qepja bëhet me kujdes. Pasi mbaruam 12-15 rrathë, fillon mbledhja, (rrudhat) hajde ngushto, ngushto derisa sa vjen në maj lart. Mbyllja lart i ve një kapak (tap) në formë rrethi një lart një poshtë.

²³ Është i vetmi person në ditët e sotme në Shqipëri që di të bëjë Takije. Iu luta me dorë në zemër që të prodhonte Takije, gjë që e bëri duke prodhuar 15 cope më 2013.

Materiali bazë për përgatitjen e Takijes është kambriku, teripi (penjtë) dhe fitilat (fije të trasha pambuku ose rripa kambriku të prera verëf dhe të dredhura. Pritet si në fig. Merret një copë kambrik në formë katërkëndëshi këndrejtë me permasë 70x70, ku priten tre takije njëhersh.

Copa e kambrikut paloset në formën e një trekëndëshi dhe priten katër copa verëf me gjërësi 26cm secila. Nga dy copat verëf të mesit përgatiten dy takije, kurse dy copat e anëve, duke qënë më të shkurtëra qepen bashkë dhe formohet me këto takija e tretë, me shtesë. Dy copat e voga që mbeten nga verëfet e mesit palosen dysh dhe priten rumbullake për majën(çaçkën) e takijes. Pas prerjes, copa verëfe me gjatësi rreth 50cm, qepet duke formuar një cilindër me perimetër 50cm, që është rrethi i takijes së zakonshme. Pastaj kthehet një pjesë dyfishe duke lënë gjatësinë e takijes 13-15 cm.

Në fillim qepet buza e rrethit të takies kalorthe, pas kësaj një pjesë rreth 5cm lartësi qepet shullalle nëpërmjet të cilave kalohen fitilat që formojnë 12- rrahtë unazorë²⁴. Pastaj shullallet vazhdojnë njëra pas tjetrës duke rrudhur pjesën e cohës njëshegradualisht deri sa takija të marrë formën e një koni me majë të çelur që mbulohet me një copë dyfishe të prerë rumbullak dhe qepet përreth kalorthe ose me psathe.



Fig. - 20
Kallëpi hapur



Fig. - 21
Kallëpi i mbyllur



Fig. - 22
Material për përgatitjen e takijes



Fig. - 23
Maket punime takijesh

²⁴ Ka dhe me 13 rrahte unazore.

Takija dhe Plisi

Takija dhe Plisi i Kosovës janë dy kësulata e bardha më të vjetra të popullit shqiptar, atij europian e më gjerë. Këto dy kësula janë paralire (pellazge), janë ilire, arbërore e shqiptare. Ato janë mbajtur nga zotat pellazgë dhe protagonistët e antikitetit e në vijimësi deri më sot nga shqiptarët.

PËRFUNDIME

1. Takija e Myzeqarit dhe Plisi i Kosovës janë dy pjesë të një veze jo të zakonshme, por të vezës kozmike. Këtë na e pohon teoria antike e krijimit të kozmosit.
2. Sipas kozmogonisë pellazge dhe paraantike, bota në fillim ishte një kaos.
3. Ky kaos u shndërrua në gjarpër (kuçedër) dhe ky gjarpër u shndërrua në pëllumb të bardhë, e ky pëllumb bëri vezën kozmike.
4. Nga çarjja e vezës kozmike doli bota (gjithësia) që quhet Pan, i cili mundësoi pamjen (dritën) e qiellit e të tokës.
5. Veza e ndarë në dy pjesë paraqet Qiellin dhe Tokën dhe të dyja së bashku pjesët e vezës kozmikë përbëjnë qiellin dhe token, gjithësinë.²⁵
6. Plisi bardhë -sipas Prof.Dr.E.Zenelaj- është simbol i gjysmëgëzhjës së vesë kozmike dhe paraqet një rën gjysmë (pjesën e epërme) të gëzhjës së vezës kozmike.²⁶
7. Meqënëse zoti Zenelaj nuk flet për gjysmën tjetër të vezës kozmike (pjesën me majë) për harresë apo për mosnjohje të Takijës²⁷ po marr mundimin ta plotësoj.
8. Gjysma e vezës kozmike (pjesa fundore ose siç thotë populli “bytha e vezës”) është Plisi dhe simbolizon qiellin, ndërsa gjysma tjetër e vezës kozmike (pjesa me majë) është Takija dhe simbolizon Tokën.

STUDIME MBËSHTETËSE DHE REFERENCA

- Ceka, Neritan. *Iliret deri te Shqiptaret*, Tiranë: Migjeni, 2014
- Colonna, Barbara. *Fjalor Mitologjik*, Tiranë: TOENA, 2005
- Konica, Faik. Vep.2. Tiranë: Dudaj, 2001
- Gjergji, Andromaqi *Veshjet Shqiptare në Shekuj*, Tiranë: Botim i Akademisë së Shkencave së RPS të Shqipërisë, V.1988
- Ikonomi, Perikli. *Tomori dhe Dodona Pellazgjike*, Tiranë: Bota Shqiptare, viti 2008
- Pilika, Dhimitër. *Pellazgët Origjina Jonë e Mohuar*, Tiranë: Botime Enciklopedike, 2005
- Thëngjilli, Petrika. *Shqiptarët midis Lindjes dhe Perëndimit 1506-1839*, Tiranë 2002
- Zenelaj, Eqrem M, *Pellazgët, Ilirët, Shqiptarët*, Prishtinë: Artini, 2020
- Zeqo, Moikom Dita, “Sinopse dhe skica arkelogjike”, gazeta Dita, 30 dhjetor 2019
- Studime Etnografike nr.2, 3.

²⁵Citim nga Prof.Dr. Eqrem M. Zenelaj, *Pellazgët, Ilirët, Shqiptarët*, Prishtinë: Artini, 2020, f.31

²⁶ Prof.,Dr..Eqrem M. Zenelaj, *Pellazgët, Ilirët, Shqiptarët*, Prishtinë: Artini, 2020, f.318

²⁷ Në fakt Prof.,Dr..Eqrem M. Zenelaj dhe shumë të tjerë nuk e njohin farë kësulën me emrin Takije.

